

P.nr.296/13

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal me gjyqtaren individuale Hakile Ilazi dhe procesmbajtësen Kaçusha Leka praktikante në këtë Gjykatë, në çështjen penale kundër të akuzuarit, B.H., për shkak të veprës penale në vazhdim vjedhja e rëndë nga neni 253 par.1 nënparë.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Komunale në Ferizaj PP.nr.1271/2011 të dt.23.07.2011, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datë 11.11.2016, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Burim Çerkini, të akuzuarit, mori dhe publikisht shpalli këtë ndërsa përpilimi me shkrim u bë me dt. 18.11.2016:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, B.H. nga Ferizaj rr.”.....” p.nr, data e lindjes.... në, nga i ati H. dhe e ëma S. e gjinis S., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, babë i një fëmije, i gjendjes së varfër ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

1. Sepse me datën 12.03.2010, rreth orës 09:30 në Ferizaj në rrugën “Enver Topalli” nr....., përkatësisht në shtëpin e të dëmtuarit R.G., me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, deri sa i dëmtuari ishte në pjesën tjetër të shtëpisë ka hyrë brenda dhe ka marrë një fshesë elektrike “Conit” në vlerë 55 € dhe 15 litra vaj në vlerë 15 €

Me të cilën kreu veprën penale vjedhja nga neni 252 par. 1 nën par 1 të KPK-së

2. Me datë 17.07.2010, rreth orës 09:30, në Ferizaj, në rrugën ‘‘Agim Matoshi’’ p.nr, përkatësisht në shtëpinë e të dëmtuarës Y.I., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, deri sa e dëmtuara ishte në pushime në Shqipëri, me përdorimin e forcës ka hapur derën e hyrjes dhe nga dhoma e fjetjes ka marrë dy fustane dhe 2 komplete të burrave, të gjitha në vlerë prej 500 € sipas të dëmtuarës,

3. Me datë 12.08.2010, në kohë të pa caktuar, në Ferizaj në rrugën ‘‘Besim Rexhepi’’ p.nr, përkatësisht në lokalit ‘‘.....’’, në lokalit e të dëmtuarës Xh.S., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, me përdorimin e forcës ka hapur derën e hyrjes dhe në lokalit pasi e ka dëmtuar ka marrë nga aparati i pikados para të metalta nga 50 cent dhe nga shankti ka marrë poashtu para të metalta në vlerë 40 euro, si dhe ka marrë një qante me ngjyrë të kaltërt ku kanë qenë të vendosura 20 €

4. Me datë 10.10.2010, rreth orës 04:00, në Ferizaj në rrugën ‘‘12 Qershori’’ p.nr, përkatësisht në depon e furrës ‘‘.....’’, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, me përdorimin e forcës ka hapur derën e hyrjes së furrës dhe nga arka ka marrë para të metalta në shumë prej 72 € sipas të dëmtuarit,

Me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 253 par.1 nënpar.1 të KPK-së

Në bazë të dispozitës së lartshënuar dhe dispozitave nga neni 285 neneve 3,6,11,15,34,38,75,76 dhe 64 të KPK-së, si dhe neni 365 të KPPK-se të akuzuarin e,

G J Y K O N

Të akuzuarin me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4/katër/ muajve, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit R.G., Y.I., Xh.S. dhe H.M. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 /njëzet e pesë/ € në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Komunale në Ferizaj PP.nr.1271/2011 të dt.23.07.2011, e ka ngarkuar të akuzuarin, B.H. për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nënpar.1 të KPK-së dhe për veprën penale në vazhdim vjedhja e rëndë nga neni 253 par.1 nënparë.1 të KPK-së, Prokurori i shtetit ka ndryshuar akuzën sa i përket diapozitivit nën 1/një/, me që është llogaritur si vepër e veçantë dhe i njëjti diapozitiv bashkohet me diapozitivin e aktakuzës 2/dy/,3/tre/dhe 4/katër . I akuzuari B.H. gjykohet për veprën penale

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze mbajti shqyrtimin fillestar me datë 11.11.2016 në të cilën përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit, Burim Çerkini mbeti në tërësi pranë akuzës, ku i njëjti në shqyrtim fillestar propozon që të ndryshohet akuza sa i përket dispozitivi nen.1 e që është llogaritur si vepër e veçantë dhe i njëjti dispozitiv bashkohet me dispozitivin të aktakuzës 2,3,4 dhe tani i akuzuari B.H. do të përgjigjet për veprën penale vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 253 par.1 nënpar.1 të KPK-së duke marruar për bazë natyrën e veprës penale dhe natyrën dhe kohën e kryerjes së tyre.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 11.11.2016, në të cilën shqyrtim i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, duke e shprehur keqardhje dhe pendim të thellë për veprën e kryer si dhe lut gjykatën që t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë dhe shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi

është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit : raporti i policit hetues të datave 12.03.2010, 17.07.2010,12.08.2010 dhe 10.10.2010.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhja e rëndë në vazhdim nga neni 253 par. 1 nënpar.1 të KPK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 64, 65, 66 dhe 67 të KPK-ës, duke i aplikuar dispozitat ligjore të zbutjes, ku bëri zbutjen nën minimumin e paraparë ligjorë nga 6/gjashtë/muaj burgim në 4/katër / muaj burgim, nga ku dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, gjendja e dobët ekonomike, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, si dhe në shqyrtimin fillestar, në rastin konkret gjeti rrethanë rënduese, se i njëjti është recidivist është i njohur për vepra të tilla penale dhe atë: aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj me numër P.nr. 1155/11 dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja dhe vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me dënimin e shqiptuar me burg do të arrihet qëllimi ndëshkimor i dënimit në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Të dëmtuarit R.G., Y.I., Xh.S. dhe H.M. në kuptim të nenit 458,459,460 për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 /njëzet e pesë /€ në afat prej 30 ditësh

Nga arsyet e sipërcekura është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.296/13 me datë 21.11.2016

Sekretarja Juridike,

Kaçusha Leka

Gjyqtarja Individuale

Hakile Ilazi

Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat, prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.